



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANING	
Njësia Org. Org. Jedinica Org. Unit	<u>DMM</u>
Nr. Prot. Broj. Prot. Prot. No.	<u>4216-2/26</u>
Nr. I faqeve Broj. stranica No. pages	<u>- 05 -</u>
Data Datum Date	<u>08/09/2026</u>
PRISHTINE/A	

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Departamenti i Mbrojtjes së Mjedisit/ Departament za Zivotnu Sredinu/
Department of Environment Protection

DATË/A:	28.08.2026
REFERENC-Ë:	26/4216-592/DMM
PËR/ZA/TO:	"Oxygen Pharma" Sh.p.k. Çagllayicë, Prishtinë
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Z. Bajram Kafexholli, U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-së Znj.Miradije Gërguri,U.D. Drejtore e DMM-së Z. Rizah Muçolli, Udhëheqës i DLLM-së
NGA/OD/FROM:	Përparim Terziu, Zyrtar i Lartë i angazhuar për Biocide
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Përgjigje në kërkesën për leje importi për produkte biocide

Të nderuar/ a,

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ka shqyrtuar kërkesën me Nr.Prot.4216/26, datë: 23.07.2026 për import të Produkteve Biocide për kompaninë "Oxygen Pharma" Sh.p.k. Prishtinë, me Certifikatë të Regjistrimit të Biznesit, NUI 810032920 dhe ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur:

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr.: 26/4216/MMPH
Datë: 28.08.2026

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 27 paragrafi 1 dhe nenit 43 të Ligjit Nr. 08/L-065 për Produktet Biocide, nenit 39 të Ligjit Nr. 08/L-116 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-197 për Kimikate, si dhe Vendimit të Qeverisë Nr.16/20 i datës 24.03.2015 nxjerr:

V E N D I M

Aprovohet kërkesa me me Nr.Prot.4216/26, datë: 23.07.2026 për import të Produkteve Biocide për kompaninë "Oxygen Pharma" Sh.p.k. Prishtinë, me Certifikatë të Regjistrimit të Biznesit, NUI 810032920

Lista e produkteve biocide që do të importohen të shënuara në tabelën e mëposhtme, substanca aktive e produkteve në fjalë **është e lejuar**, sipas Vendimit të Qeverisë Nr.16/20 të datës 24.03.2015

Substanca aktive	Produkti	Sasia / forma	Nr. i notifikimit	Cas Numër	Lloji i produktit biocid (PT)
Ethanol	Alkool Etilik i çnatyruar 95% vol 1 L	30.000 (Shishe PEHD)	5442/4216/26/KOS	64-17-5	Dezinfektues PT (01) PT (02)
Ethanol	Alkool Etilik i çnatyruar	30.000	5443/4216/26/KOS	64-17-5	Dezinfektues PT (01)



Leja për Import për produkte biocide lëshohet për periudhën 1 (një) vjeçare.

A r s y e t i m

Pas shqyrtimit të kërkesës për Leje Importi të Produkteve Biocide të kompanisë "Oxygen Pharma" Sh.p.k. Prishtinë, me Nr.Prot.4216/26, datë: 23.07.2026 për import të Produkteve Biocide, Zyrtari i Lartë i Angazhuar për Shqyrtimin e Kërkesave për Leje Importi për Produkte Biocide, konstatoi se operatori i **plotëson** kriteret e parapara në nenin 29 të Ligjit Nr. 08/L-065 për Produktet Biocide, nenin 38 dhe 39 të Ligjit Nr. 04/L-197 për Kimikate dhe nenin 38 të Ligjit Nr. 08/L-116 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-197 për Kimikate, si dhe Vendimit të Qeverisë Nr.16/20 i datës 24.03.2015

Pala ka paguar taksën administrative në vlerë prej dhjetë (10) euro për marrjen e Lejes për import për produkte biocide, siç parashihet në paragrafin 1 të nenit 41 të Ligji Nr. 08/L-116 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-197 për Kimikate.

Substanca aktive e produkteve në fjalë **është e lejuar**, sipas Vendimit të Qeverisë Nr.16/20 të datës 24.03.2015

Substanca aktive sipas deklaratës së operatorit përdoret për shitje te subjektet mjekësore private dhe publike si spitale, farmaci, klinika etj. të cilat këto produkte i përdorin për përdorim të jashtëm.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të parashtroj ankesë në afat 30 ditë nga marrjes së këtij vendimi në Komisionin e ankesave për shqyrtimin e vendimeve lidhur me lejet në Ministri.



Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Nr.: 26/4216/ZSP/ /26 date: 28.08.2026

Bajram Kafexholli

U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPH-së



Vendimi t'iu dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- DMM-së;
- Divizionit për Leje dhe Licenca Mjedisore;
- AMMK-së;
- Inspektoratit të MMPH-së;
- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPH-së;
- Arkivit të MMPH-së